



REPUBLIKA E KOSOVËS  
QEVERIA  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHMË  
INSPЕКТОРАТИ ПОЛИКОРИ КОСОВËС  
DEPARTAMENTI I INSPЕКТИМИТ  
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: **IPK/27112024/DI**  
Datë: **27.11.2024**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

### RAPORT I INSPЕКТИМИТ

<b>Titulli - objekti</b>	- Përdorimi i kamerave të trupit dhe administrimi i provave digjitale
<b>Referenca</b>	- 07/2024
<b>Data e inicimit</b>	- 28.10.2024
<b>Data e raportimit</b>	- 27.11.2024
<b>Arsyet e inicimit</b>	- Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar nivelin e përdorimit të kamerave të trupit nga ana e përdoruesve të autorizuar dhe administrimin e audio - video materialeve të regjistruara. IPK-ja është në dijeni se nga viti i kaluar, Policia ka pajisur disa njësi policore në kuadër të strukturave të saj, me kamera të trupit, pajisje të cilat janë dhuruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit (Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit), si mbështetje për reformën e sistemit të drejtësisë, ngritjen e sigurisë, avancimin e llogaridhënies në përmbushje të objektivave për të siguruar një ambient më të sigurt për qytetarët. Inspektimi ka ofruar një mundësi për t'u njohur me efektivitetin e përdorimit të sistemeve të monitorimit, ndikimin në ngritjen e performancës, qasjen në raport me qytetarët dhe administrimin e provave digjitale. Inspektimi pasqyron edhe efektet e aplikimit të sistemit dhe nevojën e zgjerimit të kësaj infrastrukture.
<b>Objektivat e inspektimit</b>	- Vlerësimi i respektimit të legjislacionit për përdorimin e kamerave të trupit, - Vlerësimi i administrimit të pronës së pranuar si donacion, - Vlerësimi i efektivitetit në funksionimin e kamerave trupore, - Vlerësimi i efektit të këtij sistemi në ngritjen e sigurisë, transparencës, llogaridhënies dhe performancës, si dhe - Vlerësimi i masave të sigurisë lidhur me administrimin e provave digjitale.
<b>Metodologjia e inspektimit</b>	- Gjatë realizimit të punës inspektuese është aplikuar metodologjia si në vijim: (a) Janë realizuar takime - intervista me drejtues dhe bartës funksionesh, si: - Drejtorin e Departamentit për Kufi, - Drejtorin e Drejtorisë së Njësive të Ndërhyrjes së Shpejtë, - Drejtorin e Drejtorisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit, - Shefat e Njësive Rajonale të Trafikut Rrugor, - Administratorin e Sistemit të Kamerave, - Zyrtarin përgjegjës të Sektorit të Pasurive; (b) Janë kryer kontrole - verifikime të: - Prezencës së kamerave të trupit nëpër njësi, - Përdorimit të kamerave, përfshirë shkarkimin e incizimeve,

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Funkcionimit të sistemit të kamerave;</li> <li>(c) Janë siguruar dokumente, apo të dhëna në formë fizike - elektronike, si: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dosja e donacionit lidhur me dhënien e donacionit,</li> <li>- Regjistrat e pranimit - dorëzimit të pajisjeve,</li> <li>- Regjistrat e pasurive,</li> <li>- Raportet e inspektimit,</li> <li>- Raportet e inventarizimit,</li> <li>- Dëshmi mbi trajnimet sipas niveleve.</li> </ul> </li> </ul>
<b>Subjekti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Rendit Publik,</li> <li>- Departamenti i Kufirit,</li> <li>Departamenti për Shërbime Mbështetëse.</li> </ul>
<b>Afatet e inspektimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fillimi i inspektimit: 05.11.2024,</li> <li>- Përfundimi: 07.11.2024,</li> <li>- Periudha e mbulimit: viti 2023 dhe gjendja aktuale.</li> </ul>
<b>Kriteri vlerësues (standardi)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë,</li> <li>- Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,</li> <li>- Rregullore MF - Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo-financiare në Organizata Buxhetore,</li> <li>- Marrëveshje për donacion ndërmjet Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.</li> </ul>
<b>Takimi përmbyllës IPK-Policia e Kosovës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Më 26.11.2024 është realizuar takimi përmbyllës me strukturën policore të inspektuar, të përfaqësuar nga drejtues e bartës funksionesh nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Departamenti për Kufi, dhe</li> <li>(b) Departamenti i Rendit Publik,</li> </ul> </li> </ul>
<b>Komentet policore lidhur me gjetjet e rekomandimet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Më 27.11.2024, struktura e inspektuar policore ka kthyer komentet lidhur me rekomandimet dhe Planin e realizimit të tyre, të cilat janë bërë pjesë e këtij Raporti të inspektimit.</li> </ul>

<b>Ekipi realizues</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fitore Gajraku, inspektor,</li> <li>- Mirsad Puqurica, inspektor,</li> <li>- Servet Tasholli, inspektor,</li> <li>- Teutë Rukolli, Ajeti, inspektor,</li> <li>- Xhavit Fetahaj, inspektor,</li> <li>- Shqiponjë Sopi, inspektor.</li> </ul>
<b>Mbikëqyrur nga</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ilir Idrizaj,</li> <li>Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit</li> </ul>
<b>Mbështetur nga</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bujar Mustafa,</li> <li>Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi</li> </ul>
<b>Dorëzuar nga</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bekim Pira,</li> <li>Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit</li> </ul>
<b>Miraturar nga</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtrim Hodaj,</li> <li>Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së</li> </ul>
<b>Datë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 27.11.2024</li> </ul>

**Shkurtesat**

<b>AIP</b>	<b>Agjencia për Informim dhe Privatësi</b>
<b>DIMP</b>	<b>Drejtoria për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun</b>
<b>DTIK</b>	<b>Drejtoria për Teknologji Informative dhe Komunikim</b>
<b>IPK</b>	<b>Inspektorati Policor i Kosovës</b>
<b>LMDHP</b>	<b>Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b>
<b>NJKA</b>	<b>Njësia për Kontrollin e Autostradave</b>
<b>NJRTRR</b>	<b>Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor</b>
<b>PSO</b>	<b>Procedura Standarde e Operimit</b>
<b>SIMFK</b>	<b>Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave dhe Kontrollit</b>
<b>SMPD</b>	<b>Sistemi i Menaxhimit të Provave Digjitale</b>
<b>QR</b>	<b>Quick Response Code</b>

## Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

### Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✚ Njësitë Rajonale të Trafikut Rrugor përdorin në masë të konsiderueshme kamerat e trupit, por ka vërejtje mbi kohëzgjatjen e regjistrimeve, meqë nuk mbulojnë mjaftueshëm aktivitetet operative.
- ✚ Bazuar në të dhënat e Sistemit të Menaxhimit të Provave Digjitale, njësitë dhe stacionet policore të mbikëqyrjes së kufirit në kuadër të Departamentit për Kufi, nuk kanë përdorur kamerat e trupit.
- ✚ Përdoruesit e kamerave të trupit nuk janë duke klasifikuar regjistrimet sipas llojit të aktiviteve apo ngjarjeve nga terreni dhe kjo mund të ketë ndikim negativ në përcjelljen e afateve të ruajtjes siç parashihet me procedurat në fuqi.
- ✚ Projekti i sistemit të kamerave të trupit ka pasur sfida dhe vështirësi gjatë implementimit, të cilat janë të natyrës objektive dhe subjektive (problemet teknike në funksionimin e sistemit, hezitimi dhe adaptimi me vështirësi i përdoruesve në raport me kamerat e trupit dhe vetë sistemin, lëvizjet brenda strukturave, etj.).
- ✚ Ka pasur raportime jo të mjaftueshme mbi inspektimet e realizuara nga mbikëqyrësit, me gjithë faktin se ka pasur ngecje dhe probleme evidente në funksionimin e duhur të sistemit në fjalë. Inventarizimet e pajisjeve në baza tre mujore nuk janë realizuar, me gjithë faktin se kanë qenë pjesë e Marrëveshjes me donatorin.

### Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të Policisë së Kosovës, që në drejtim të kontrollit efektiv të pajisjeve të marra si donacion, të angazhojë komisione për realizimin e inventarizimeve periodike në baza tre mujore, ashtu siç janë marrë obligimet nga Marrëveshja e Donacionit.
2. IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Divizionit të Trajnimeve, që në koordinim me njësitë që janë pajisur me kamera të trupit të identifikojnë zyrtarët policor që nuk janë të trajnuar dhe në të ardhmen të organizojnë trajnime në përdorimin e kamerave dhe administrimin e provave.
3. IPK u rekomandon shefave të njërive rajonale të trafikut rrugor dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të organizojnë inspektime të kohëpaskohshme mbi funksionimin e sistemit dhe përdorimin e mjaftueshëm të kamerave të trupit, duke mbuluar pjesë të rëndësishme të aktiviteve në terren, siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit - Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit (lidhur me inspektimet, të hartohen raporte).
4. IPK i rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Kufirit, që urgjentisht të fillohet me përdorimin e kamerave të trupit dhe materialet e regjistrimeve video – audio të mbulojnë pjesë të rëndësishme të aktiviteve operative siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit - Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit.
5. IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që të zgjerojë sistemin e përdorimit të kamerave të trupit edhe në njësi tjera policore, meqenëse mund të jenë mjet i fuqishëm në ngritjen e integritetit, kontrollit efektiv në përdorimin e forcës dhe trajtimin e incidenteve.
6. IPK u rekomandon përdoruesve dhe mbikëqyrësve të njërive rajonale të trafikut rrugor, që me rastin e përdorimit të kamerave të trupit, apo me rastin e shkarkimit të provave digjitale, të kujdesen që ato klasifikohen për qëllime të ruajtjes dhe administrimit të duhur të tyre.
7. IPK u rekomandon përdoruesve të kamerave të trupit, që gjithëherë kur i përdorin ato për qëllime operative, t'i njoftojnë palët se janë të ekspozuar gjatë monitorimit të ushtruar.
8. Me gjithë ngarkesën në punë, problemet teknike në sistem dhe sfidat në implementimin e projektit, IPK i rekomandon Administratorit të Sistemit të Kamerave, që shtojë përpjekjet për procedimin me kohë të kërkesave që vijnë nga njësitë policore që janë ngarkuar me përdorimin e sistemit të kamerave.

Gjetjet kryesore:



## 1. Baza ligjore dhe autorizimet

1.1. Policia e Kosovës është agjenci me kompetenca të ndara në fushën e sigurisë, mes tjerash edhe në ruajtjen e rendit e qetësisë publike, kontrollin e kufijve shtetëror, kontrollin e trafikut dhe sigurisë rrugore dhe parandalimin dhe luftimin e krimit. Personelit të saj në funksion të një efikasiteti dhe efektiviteti më të lartë në ushtrimin e autorizimeve i është lejuar përdorimi i një varg pajisjesh policore, kurse viteve të fundit me zhvillimin teknologjik, edhe të kamerave të trupit. Përmes përdorimit të kamerave rritet mundësia dhe aftësia policore në zbatimin efektiv dhe efikas të ligjit, mundësohet sigurimi i provave për ndjekje penale, mbrohet personeli nga akuzat e rreme për sjellje të keqe, mundësohet dokumentimi i ndërveprimit me publikun, etj. Kamera e trupit paraqet zhvillim teknologjik në fushën e monitorimit, që po përdoret në vende që aplikojnë standarde të larta të policimit demokratik. Këto janë pajisje, por edhe sistem multi funksional për regjistrim/incizim audio video, i destinuar për përdoruesit si mundësi shtesë për dokumentimin e incidenteve dhe ngjarjeve të ndryshme nga terreni. Materiali që regjistrohet përmes sistemit mund të ruhet dhe të shërbejë si mjet në funksion të hetimit, trajtimit të incidenteve, zgjidhjes së ankesave të ndryshme, rritjes së transparencës e llogaridhënies, si dhe fuqizimit të integritetit.

1.2. Nëse i referohemi bazës ligjore, që hap rrugën për përdorimin e kamerave të trupit, duhet cekur se ajo është e gjerë. Mbledhja dhe regjistrimi i imazheve të marra nga sistemi i vëzhgimit me kamerë përbën përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë duhet bërë duke respektuar parimet e përpunimit të të dhënave personale. Sa i përket parimit të ligjshmërisë, përpunimi i të dhënave personale buron nga Ligji për Policinë. Neni 25 i Ligjit përcakton që Policia është e autorizuar të bëjë vëzhgim parandalues të vendit publik, duke përdorë pajisje për incizime video akustike dhe pajisje fotografike për t'i vëzhguar vendet publike ku në të kaluarën shpesh janë kryer vepra penale, apo kur ka arsye të bazuar të besohet se vëzhgimi publik do ta zvogëlonte rrezikun nga kryerja e veprave penale dhe do të përmirësonte sigurinë publike në të ardhmen, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale. Kurse, neni 31 i këtij Ligji përcakton që Policia është e autorizuar të mbledhë dhe të ruajë të dhënat personale, të dhënat mbi krimin dhe të dhënat tjera.

1.3. Duke parë të nevojshme përdorimin e kamerave të trupit, Policia e Kosovës themeloi Grup punues për hartimin e Procedurës Standarde të Operimit - Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit. Ky Grup ka nxjerrë këtë dokument, i cili është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë më 20.06.2023. PSO ka rregulluar mënyrën e përdorimit të kamerave, ka ndarë përgjegjësitë për përdoruesit dhe mbikëqyrësit, administrimin e provave dhe ruajtjen e tyre, etj. Me qëllim që përdorimi i kamerave të trupit të përmbushë kriteret ligjore që dalin nga Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, PSO është dërguar për analizë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi. AIP ka mbështetur projektin dhe dokumentin në fjalë se ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave dhe parimeve të Ligjit përkatës në fuqi (ligjshmërinë, transparencën, kufizimin e qëllimit, minimizimin e të dhënave, saktësinë, kufizimin e ruajtjes, paprekshmërinë dhe konfidencialitetin, si dhe llogaridhënien), dhe në drejtim të përmbushjes së plotë të kriterëve ligjore, kishte rekomanduar ndërmarjen edhe të disa veprimeve shtesë, përfshirë: caktimin e zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave për mbikëqyrjen e zbatimit të projektit, draftimin e një modeli të kërkesës për qasje në të dhëna, si dhe njoftimin e publikut përmes lansimit të fushatave mediale me qëllim të informimit publik mbi projektin në fjalë. Inspektimi vë në pah se këto rekomandime janë përmbushur.

1.4. Lidhur me rekomandimin e tretë, DIMP me qëllim të rritjes së transparencës, informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve, ka publikuar komunikata për medie lidhur me fazën testuese dhe implementuese të kamerave të trupit. Po ashtu, është përgatitur edhe një videoklip vetëdijesimi, që është i qasshëm në kanalën zyrtar të Policisë në Youtube. Si pjesë e promovimit dhe informimit publik për përdorimin e

kamerave të trupit, në shumë medime televizive dhe rrjete sociale janë plasuar kronika, apo reportazhe me njësi policore në terren.

## 2. Pajisja me kamera të trupit

2.1. Nuk është hasur në të kaluarën që Policia e Kosovës të jetë pajisur me sisteme të tilla të monitorimit, deri në vitin e kaluar kur Departamenti Amerikan i Shtetit përmes Byrosë për Çështje të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit kishte vendosur që në kuadër të mbështetjes së reformës në sistemin e drejtësisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mbështes ndihmën për zhvillim të Policisë së Kosovës, përmes trajnimit dhe sigurimit të pajisjeve për zhvillimin e kapaciteteve të saj. Vlera e kësaj prone që i është bartur Policisë së Kosovës së bashku me shërbimet tjera të mirëmbajtjes dhe trajnimit ka kapur vlerën prej 1.785.235 dollarë. Marrëveshja për Donacionin e arritur ndërmjet palëve më 01.08.2023, kishte paraparë sigurimin e 250 kamerave të trupit, serverin dhe pajisjet përcjellëse për funksionimin e sistemit. Sipas regjistrave të pranimit-dorëzimit të këtyre pajisjeve, pasqyrohet se shpërndarja e kamerave të trupit është realizuar nga Drejtoria e Logjistikës në periudhën nga 22 deri më 28.08.2023, edhe atë sipas kësaj formule:

- <b>Departamenti i Rendit Publik</b>	<b>145 copë</b>
▪ NJRTRR - Ferizaj	15 copë,
▪ NJRTRR - Gjakovë	15 copë,
▪ NJRTRR - Gjilan	15 copë,
▪ NJRTRR - Pejë	15 copë,
▪ NJRTRR - Prishtinë	30 copë,
▪ NJKA	10 copë,
▪ NJRTRR - Prizren	15 copë,
▪ NJRTRR - Mitrovicë Jugu	15 copë,
▪ NJRTRR - Mitrovicë Veriu	15 copë,
- <b>Departamenti i Kufirit</b>	<b>105 copë</b>
▪ NJNSH - Qendër	10 copë,
▪ NJNSH - Lindje	10 copë,
▪ NJNSH - Perëndimi	10 copë,
▪ NJNSH - Veriu	10 copë,
▪ QNJS - Belvedere	5 copë,
▪ SPMK - Gjilan	5 copë,
▪ SPMK - Hani i Elezit	5 copë,
▪ SPMK - Kllokot	5 copë,
▪ SPMK - Muçivërcë	5 copë,
▪ SPMK - Dragash	5 copë,
▪ SPMK - Ponošec	5 copë,
▪ SPMK - Vërmicë	5 copë,
▪ SPMK - Vitomiricë	5 copë,
▪ SPMK - Leposaviq	5 copë,
▪ SPMK - Keqekollë	5 copë,
▪ SPMK - Kërpimëh	5 copë,
▪ SPMK - Zubin Potok	5 copë.

2.2. Rregullorja MF - Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore në nenin 6 përcakton që “çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnojë regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj”. Rregullorja më tutje përcakton që “regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale me vlerë individuale mbi 1.000 € dhe afat të përdorimit më shumë se 1 vit, pasuritë jokapitale me vlerë individuale më të vogël se 1.000 € dhe afat të përdorimit më shumë se 1 vit, si dhe stoqet”. IPK është interesuar të njihet me këtë regjister të pasurive, nëse përmban edhe pajisjet e pranura si donacion. IPK-ja ka siguruar të dhëna se Sektori i Pasurive në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa mbanë

	<p>regjistrin e pasurive me të dhëna të pajisjeve të marra si donacion, edhe atë në kuadër të SIMFK për vlerat mbi 1.000 € dhe Regjistrin e Pasurive me vlerë nën 1.000 €. Kjo nënkupton që disa prej pajisjeve të konsideruara kapitale janë regjistruar në SIMFK, ndërsa pajisjet tjera të konsideruara si jo kapitale janë regjistruar në sistemin “e-pasuria”. IPK ka inspektuar gjendjen fizike të kamerave të trupit dhe prezencën e tyre në njësitë e trafikut. Kamerat janë hasur të gjitha në numër ashtu siç janë shpërndarë nëpër njësi. Edhe stacionet mbushëse janë hasur në gjendje të mirë teknike. Meqë sipas Rregullores përcaktohet që organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare, IPK ka vërejtur se inventarizimi ka ndodhur për vitin 2023, ku janë përfshirë dhe pajisjet e pranuar si donacion. Me gjithë faktin se inventarizimi i rregullt konform Rregullores ka ndodhur, duhet pasur parasysh se Marrëveshja e Donacionit obligon Qeverinë që çdo tremujor të bëjë inventarizimin e plotë dhe numërimin fizik sipas numrit serik<sup>1</sup>. Inventarizimet në baza tremujore nuk janë realizuar, si obligim i dalur nga Marrëveshja e Donacionit.</p> <p>2.3. Bazuar në PSO, vetëm zyrtarëve policor të autorizuar dhe të trajnuar iu lejohej të vendosin dhe mbajnë kamera në trup. PSO gjithashtu parasheh që para përdorimit, operatori duhet të jetë i trajnuar në përdorimin e saj dhe pajisjeve përcjellëse. Ky dokument ka paraparë trajnimin sipas niveleve, përfshirë trajnimin për operatorët në përdorimin e kamerave të trupit dhe transferimin e provave digjitale, trajnimin e mbikëqyrësve, trajnimin për ekipin teknik për instalim, konfigurim e mirëmbajtje të sistemit, si dhe trajnimin për personelin e Flotës Operative për instalimin e pajisjeve përcjellëse të kamerave në automjete. Fillimisht janë realizuar dy (2) trajnime nga donatori, ku kanë marrë pjesë 64 pjesëmarrës, kurse nga Divizioni i Trajnimeve janë organizuar edhe 46 trajnime të tjera me 522 pjesëmarrës, duke ngritur kështu në 48, numrin e trajnimeve dhe në 586, numrin e pjesëmarrësve. Siç u cekë edhe më lartë, fillimisht janë trajnuar dhe certifikuar një numër trajnerësh për disa nivele, të cilët më pas kanë trajnuar zyrtarët tjerë policor. Trajnime mbi përdorimin e kamerave janë mbajtur dhe tash së fundmi pasi në disa njësi, kryesisht në Departamentin e Kufirit ka pasur ndryshime në strukturën e personelit dhe ardhje të reja, të cilët nuk kanë pasur njohuri mbi përdorimin e kamerave të trupit.</p> <p><b>3. Performanca, sfidat dhe vështirësitë</b></p> <p>3.1. Sa i përket përdorimit të kamerave të trupit, pasqyrohet se zbatimi i këtij sistemi ka filluar me njësitë rajonale të trafikut, kurse ka pasur ngecje të konsiderueshme në kuadër të Departamentit të Kufirit. Zyrtarët përgjegjës janë deklaruar se ka pasur shumë ngecje në implementimin e projektit, përfshirë dhe instalimin e pajisjeve në bazat e njërive të pajisura me këtë sistem. Sipas përgjegjësve nga DTIK, kamerat e trupit janë në përdorim kryesisht nga njësitë e trafikut, kurse tanimë pas stabilizimit të sistemit, përdorimi i tyre ka filluar edhe në Departamentin e Kufirit (NJNSH dhe SPMK). Sipas tyre, pasi kanë të bëjnë me sistem të ri të papërdorur më parë, sfidat e vështirësitë në përdorimin e kamerave dhe vetë sistemit kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë evidente dhe të natyrave të ndryshme. Administratori i Sistemit të Kamerave potencon që meqë kanë të bëjnë me sistem risi në Polici, edhe zyrtarët policor ende nuk janë mirë të adaptuar me kamerat e sistemin. Për stafin që administron sistemin, sfida paraqitet regjistrimi i përdoruesve, organizimi e kategorizimi i tyre në sistem. Vështirësi tjera përmenden edhe listat dinamike të policëve me shumë lëvizje nëpër njësi, ristrukturimi i njërive, etj. Për shkak të angazhimit në pjesën veriore të vendit, ristrukturimit të njërive, nuk është arritur të bëhet regjistrimi dhe akomodimi i tërësishëm i zyrtarëve në sistem, andaj edhe nuk ka filluar në mënyrë të mirëfilltë përdorimi i tyre. Administratori i Sistemit tutje sqaron se pothuajse nga fillimi, ky sistem ka pasur telashe teknike në funksionim. Shumicën e kohës ka pasur vështirësi</p>
--	---

<sup>1</sup> Neni 7, pika E e Marrëveshjes për Donacion ndërmjet Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Dispozitat specifike për Qeverinë e Republikës së Kosovës).

	<p>në funksionimin e serverëve regjional në transferimin e incizimeve, për shkak se ka qenë në funksion një version jo stabil i sistemit. Është kërkuar disa herë intervenimi nga kontraktori për rregullimin e defekteve, të cilat kanë vazhduar të shfaqen kohë pas kohe. Kjo situatë ka qenë e evidente deri para disa javëve, derisa kontraktori ka instaluar versionin më të ri të sistemit, i cili edhe e ka stabilizuar funksionimin.</p> <p>3.2. Gjatë inspektimit, ekipi i inspektimit është interesuar të njihet edhe me procesin e regjistrimit të përdoruesve, gjenerimin e QR kodeve<sup>2</sup>, krijimin e qasjeve në sistem, përdorimin e kamerave, shkarkimin e materialeve të regjistruara, transferimin e tyre në serverët regjional dhe ruajtjen në Data center. Fillimisht plotësohen kërkesat me të dhëna për zyrtarët policor dhe listat i dërgohen Administratorit, i cili i regjistron si përdorues në SMPD<sup>3</sup>. Përdoruesit janë të obliguar më pas të nxjerrin QR kodet, që secila prej tyre ka një llogari ku regjistrohen dhe ruhen incizimet e përdoruesve. Përdoruesit në fillim të orarit pranojnë kamerat nga njësitë mbushëse, i identifikojnë përmes QR kodeve dhe i përgatisin për përdorim (është hasur një praktikë e mirë tek disa njësi të trafikut ku pranim-dorëzimi i kamerave të trupit evidentohet në regjistër të veçantë). PSO ka precizuar rastet kur kamerat e trupit duhet aktivizuar, marrë parasysh edhe situatat kur ato duhet të jenë pasive. Kamera e trupit në fund të orarit dorëzohet dhe duke u vendosur në stacion (njësi) mbushës<sup>4</sup>, mundësohet shkarkimi i incizimeve, prova këto që transferohen në serverët rajonal dhe më pas barten për ruajtje në Qendrën për ruajtjen e të dhënave<sup>5</sup>. I gjithë procesi ka sfiduar përdoruesit e kamerave dhe ka pasur vështirësi në adaptimin e kësaj praktike, me përshtypjen se ngarkon përdoruesit me protokollin e një sërë veprimesh që duhet marrë. Edhe pse ka një përdorim jo të mjaftueshëm të këtij sistemi, efektet pozitive të shfrytëzimit të provave japin sinjal se sistemi do të jetë më i pranueshëm dhe racionalisht i përdorur.</p> <p>3.3. IPK-ja ka siguruar informacion përmes Administratorit të Sistemit të Kamerave, sipas të cilave sistemi ka 691 përdorues të regjistruar me user name aktiv (NJRTRR dhe NJKA kanë 462 përdorues, kurse Departamenti i Kufirit, 229 të tillë). Në tre muajt e fundit, llogaritë e 162, 163 dhe 202 përdoruesve kanë regjistruar materiale audio dhe video nga aktivitetet e tyre në terren. Pothuajse i tërë materiali i ruajtur në këtë sistem ka prejardhje nga aktiviteti i njësive të trafikut. Në muajin e fundit, 29% e atyre që kanë llogari të përdorimit në sistem kanë përdorur kamerat e trupit dhe kryesisht janë nga NJRTRR/NJKA. Përdoruesit e regjistruar nga Departamenti për Kufi nuk kanë pasur aktivitet në përdorimin e kamerave, me disa përjashtime, derisa pjesa tjetër e përdoruesve të regjistruar që nuk kanë aktivizuar kamerat përfshijnë shefat, mbikëqyrësit, apo ata që kanë mundur të jenë në pushime apo trajnime. IPK ka analizuar dhe matur kohëzgjatjen e incizimeve për të verifikuar sa janë aktivizuar kamerat e trupit gjatë orarit të punës të zyrtarëve nga njësitë e trafikut. Është matur koha e përdorimit të kamerave të trupit nga 45 përdorues të njësive të trafikut, në periudhën 15 - 31 tetor 2024, mostër kjo që përfaqëson 22% të përdoruesve të muajit të fundit. Koha e përgjithshme mesatare e përdorimit të kamerave brenda orarit tetë (8) orë është rreth 25 minuta. Nëse marrim parasysh këtë kohë të shprehur në minuta në raport me orarin tetë orë (480 minuta) rezulton se kamerat janë përdorur në 5% të kohës së qëndrimit në punë. Në vijim pasqyrohet koha mesatare për secilën njësi:</p>
--	---

<sup>2</sup> Kodi QR nënkupton kodin përmes të cilit operatori i shoqërohet kamera e trupit. Ky kod gjenerohet nga sistemi për secilin operator që përdorë kamerën e trupit.

<sup>3</sup> SMPD është sistem apo softuer që shërben për menaxhimin e kamerave të trupit, provat digjitale, përdoruesit e sistemit dhe kamerave dhe mediumin ruajtës të sistemit.

<sup>4</sup> Njësitë /stacionet mbushëse nënkupton pajisjet, të cilat shërbejnë për mbushjen e baterive të kamerave të trupit. Këto pajisje shërbejnë gjithashtu për shkarkimin e të dhënave (provave digjitale) nga kamera e trupit dhe transferin automatik dhe ruajtjen e tyre në Qendrën për ruajtjen e provave digjitale.

<sup>5</sup> Qendra për ruajtjen e të dhënave nënkupton qendrën e të dhënave (Data Center) dhe/ose dhomat e serverëve nëpër drejtori rajonale, në të cilat ruhen të dhënat elektronike të Policisë. Në to vendosen serverët që shërbejnë për ruajtjen e provave digjitale nga kamera e trupit.




(a) NJRTRR - Ferizaj	26 minuta	(5 mostra)
(b) NJRTRR - Gjakovë	7 minuta	(5 mostra)
(c) NJRTRR - Gjilan	13 minuta	(5 mostra)
(d) NJRTRR - Pejë	15 minuta	(5 mostra)
(e) NJRTRR - Prizren	11 minuta	(5 mostra)
(f) NJRTRR - Prishtinë	58 minuta	(5 mostra)
(g) NJRTRR - Mitrovicë Jugu	28 minuta	(5 mostra)
(h) NJRTRR - Mitrovicë Veriu	37 minuta	(5 mostra)
(i) NJKA	26 minuta	(5 mostra)

3.4. Në kapitullin VI (Procedurat), pika 6.17 të PSO-së ku përcaktohen përgjegjësitë e operatorit, potencohet që është përgjegjësi e operatorit të bëjë klasifikimin e incizimeve – provave digjitale të regjistruara nga kamera, të cilën e ka pasur në përdorim sipas kategorisë, të cilës mund t'i përkasin. Klasifikimin mund ta bëjë në vend ngjarje kur është e mundur, apo pas transferimit të provave digjitale në sistem së bashku me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë. Inspektimi pasqyron se klasifikimi i materialeve të incizuara nga kamerat nuk është duke u ndërmarrë, gjë që e dëshmon edhe Administratori i Sistemit të Kamerave dhe shefat e njësisve të trafikut. Sipas dhënave të sistemit, në tre muajt e fundit janë prodhuar dhe ruajtur 3.495 (gusht), 3.119 (shtator) dhe 4.431 incizime (tetor). Nëse marrim për bazë periudhën nga 15-31 tetor, nga 2.557 incizime, vetëm 36 prej tyre plotësojnë kriterin e klasifikimit (1.4%), derisa pjesa tjetër prej 2.521 incizimeve janë të pa klasifikuara (98.6%)

3.5. Për të rritur transparencën dhe respektuar liritë e qytetarëve, PSO përcakton që zyrtarët policor duhet t'i informojnë qytetarët se kamera e tyre e trupit është e ndezur dhe se është duke regjistruar qysh në fillim të kontaktit ose në rastin e parë kur është e sigurt për ta bërë. Sipas Administratorit të Sistemit të Kamerave, në fillim zyrtarët policor kanë qenë më të kujdesshëm në njoftimin e palëve se janë nën monitorim të kamerave të trupit, por më vonë ndoshta për shkak të rutinës së punës ka filluar të neglizhohet pak më shumë kjo çështje. Edhe pse sipas shefave të njësisve të trafikut, njoftimi i palëve ndodhë, inspektimi i realizuar vë në pah se ka mungesë serioziteti në përmbushjen e këtij obligimi dhe ndodhë që palët nuk po informohen se janë të ekspozuar ndaj syrit të kamerave të trupit.

3.6. IPK ka shprehur interesim lidhur me mbikëqyrjen e përdorimit të kamerave të trupit dhe ka pasur fokusin te aplikimi i inspektimeve, për t'u siguruar se ato mbahen dhe përdoren në mënyrën e duhur. Lidhur me përgjegjësitë e mbikëqyrësve, PSO përcakton që ata mes tjerash bëjnë inspektime për t'u siguruar që të gjithë vartësit e tyre janë duke i përdorur kamerat në përputhje me procedurat e Policisë së Kosovës dhe për qëllim të vlerësimit të zyrtarëve policor. Sipas deklarimeve të shumicës së mbikëqyrësve, inspektimet ndodhin por në shumtën e rasteve janë të përgjithshme dhe jo me fokus të veçantë në përdorimin e kamerave të trupit. Inspektimi në njësitë e trafikut dëshmon se ka nga to që organizojnë edhe inspektime të përdorimit të kamerave, ku duhet përmendur NJRTRR- Prizren dhe NJRTRR - Pejë. Pasqyrohet se shumica e mbikëqyrësve nuk kanë hartuar raporte mbi inspektimet e kamerave të trupit.

3.7. Lidhur me ruajtjen e qasjen në prova digjitale të siguruar nga sistemi i kamerave të trupit, Ligji në fuqi përcakton detyrimet e autoriteteve në respektimin e parimeve të paprekshmërisë dhe konfidencialitetit. Lidhur me aplikimin e masave të sigurisë për tërheqjen e provave, PSO përcakton se provat digjitale do të përdoren me qëllim të hetimit të veprave penale, aksidenteve, shkeljeve disiplinore, kundërvajtjeve, etj., të cilat mund të ndodhin gjatë përdorimit të kamerave të trupit dhe mund të përdoren si dëshmi apo provë materiale nga institucionet e drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit, gjykatat, prokuroritë, Policia e Kosovës, IPK, Avokati i Popullit. IPK-ja ka hasur që DTK ka në zbatim formularin standard të Kërkesës për prova digjitale, që përdoret nga palët kur aprovet tërheqja e provave. Kjo Kërkesë del edhe si rekomandim i AIP-së me rastin e analizës që i ka bërë projektit dhe PSO-së.

<p><b>Vlerësimi i përgjithshëm (përfundime)</b></p> 	<p>Nga gjetjet e këtij inspektimi pasqyrohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. Projekti i kamerave të trupit si një arritje në fushën e policimit demokratik para se të implementohet ka marrë mbështetje ligjore dhe nga autoriteti kompetent dhe lidhur me të ka pasur një fushatë senzibilizuese për publikun.</li> <li>1.2. Rekomandimet e dhëna nga autoriteti përkatës në drejtim të përmbushjes së plotë të kërkesave dhe parimeve ligjore, janë zbatuar nga Policia e Kosovës.</li> <li>1.3. Kamerat e trupit dhe i gjithë sistemi dhe pajisjet përcjellëse janë financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe kontingjenti i është ndarë Departamentit të Kufirit dhe njësisve rajonale të trafikut rrugor.</li> <li>1.4. Kamerat dhe pajisjet përcjellëse janë regjistruar në regjistrat e pasurive dhe janë përfshirë në procesin e rregullt të inventarizimit, por inventarizim në baza tremujore konform Marrëveshjes së Donacionit nuk ka pasur.</li> <li>1.5. Verifikimi i 145 kamerave të trupit, të shpërndara në njësi rajonale të trafikut pasqyron se ato janë hasur në numër dhe në gjendje funksionale.</li> <li>1.6. Para dhe gjatë implementimit të projektit janë organizuar trajnime për trajnerët dhe më pas edhe për përdoruesit, mbikëqyrësit dhe administratorët.</li> <li>1.7. Përdorimi i kamerave në njësitë e trafikut ka filluar që nga viti i kaluar, kurse në kuadër të Departamentit të Kufirit ka pasur ngecje dhe pothuajse ka pasur iniciativa minore për përdorim.</li> <li>1.8. Ndër arsytet e ngecjes së implementimit të projektit numërohen vështirësitë për t'u adaptuar me këtë metodë pune, vështirësitë teknike të sistemit, ndryshimet strukturore, ngarkesat e administratorëve, etj.</li> <li>1.9. Softueri i menaxhimit të provave digjitale ka pasur probleme evidente teknike në transferimin e regjistrimeve dhe këtë vit janë sanuar problemet me të si rezultat i aplikimit të versionit të ri.</li> <li>1.10. I gjithë procesi ka sfiduar përdoruesit e kamerave dhe ka pasur vështirësi në adaptimin e kësaj praktike, me përshtypjen se ngarkon përdoruesit me një sërë veprimesh. Edhe pse ka një përdorim jo të mjaftueshëm të këtij sistemi, efektet pozitive të shfrytëzimit të provave japin sinjal se sistemi do të jetë më i pranueshëm dhe racionalisht i përdorur.</li> <li>1.11. Përdoruesit nga njësitë e trafikut edhe pse i përdorin në masë të konsideruar kamerat e trupit, kohëzgjatja e regjistrimeve të marra nga terreni nuk arsyeton në masën e nevojshme përdorimin e kamerave të trupit.</li> <li>1.12. Klasifikimi i regjistrimeve sipas natyrës së ngjarjeve nuk është duke ndodhur, apo është duke ndodhur rrallë.</li> <li>1.13. Ka vërejtje sa i përket njoftimit të qytetarëve në rastet kur ata i ekspozohen monitorimit me kamerë, siç duket më tepër si rezultat i neglizhencës dhe rutina e veprimeve në punë.</li> <li>1.14. Inspektimet që parashihen të realizohen nga mbikëqyrësit e përdoruesve lidhur me përdorimin e kamerave janë të rralla dhe nuk ka raporte të mjaftueshme.</li> <li>1.15. Protokolli i tërheqjes së provave i nënshtrohet masave të sigurisë, ku janë hasur raste kur tërheqjet janë realizuar pas miratimit të kërkesave në formular.</li> <li>1.16. Përdorimi i kamerave edhe pse është shoqëruar me sfida dhe vështirësi, ka filluar të jap efektet e para, ngase provat digjitale po përdoren për të ndriçuar incidentet/problemet/situatat kur ka ndërveprim të Policisë me publikun.</li> </ol>
---	---

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të Policisë së Kosovës, që në drejtim të kontrollit efektiv të pajisjeve të marra si donacion, të angazhojë komisione për realizimin e inventarizimeve periodike në baza tre mujore, ashtu siç janë marrë obligimet nga Marrëveshja e Donacionit.	-1-	Me qëllim të kontrollit më efektiv të pajisjeve të marra si donacion, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim/koordinim me Departamentin e Kufirit dhe Departamentin e Rendit Publik do të bëjë inventarizimin periodik ashtu siç janë marrë obligimet nga Marrëveshja e Donacionit.	Në baza tre mujore
2.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Divizionit të Trajnimeve, që në koordinim me njësitë që janë pajisur me kamera të trupit të identifikojnë zyrtarët policor që nuk janë të trajnuar dhe në të ardhmen të organizojnë trajnime në përdorimin e kamerave dhe administrimin e provave.	-1-	Divizioni i Trajnimeve administron statistikat e mbajtjes së trajnimit nga secili zyrtar policor. Ndërsa trajnerët janë ata që mbajnë trajnimin në terren. Divizioni i Trajnimeve do të kërkojë nga DRP-të dhe Divizioni i Trafikut që të përcjellin listat me emrat e zyrtarëve të cilët do të trajnohen në mënyrë që Divizioni i Trajnimeve të jenë të përgatitur me trajner të mjaftueshëm.	Në vazhdimësi
3.	IPK u rekomandon shefave të njësisë rajonale të trafikut rrugor dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të organizojnë inspektime të kohëpaskohshme mbi funksionimin e sistemit dhe përdorimin e mjaftueshëm të kamerave të trupit, duke mbuluar pjesë të rëndësishme të aktiviteteve në terren, siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit - Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit (lidhur me inspektimet, të hartohen raporte).	-1-	Drejtori i Departamentit të Rendit Publik urdhëron Drejtorët Rajonal dhe Shefat e Operativës Rajonale që përmes Komandantëve të Njësive të Trafikut (NJRTRR dhe NJKA) të kryejnë inspektime dhe të përdorin metoda të ndryshme në mënyrë që të ushtrojnë kontroll të shtuar që çdo zyrtar policor të i përdor mjaftueshëm kamerat e trupit, ashtu siç parashihet me PSO "Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit".	Në vazhdimësi
4.	IPK i rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Kufirit, që urgjentisht të fillohet me përdorimin e kamerave të trupit dhe materialet e regjistrimeve video – audio të mbulojnë pjesë të rëndësishme të aktiviteteve operative siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit - Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit.	-1-	Drejtori i Departamentit të Kufirit urdhëron Drejtorët e Divizioneve/Drejtorive përkatëse të Kufirit të filloj me implementimin e rekomandimit të dhënë nga IPK-ja duke filluar përdorimin e menjëhershëm të kamerave të trupit ashtu siç parashihet me PSO "Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit" si dhe të filloj me trajnime të menjëhershme me zyrtarët lidhur me përdorimin e kamerave të trupit.	Në vazhdimësi
5.	IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që të	-1-	Policia e Kosovës planifikon që të zgjerojë përdorimin e kamerave të	Në vazhdimësi

	zgjerojë sistemin e përdorimit të kamerave të trupit edhe në njësi tjera policore, meqenëse mund të jenë mjet i fuqishëm në ngritjen e integritetit, kontrollit efektiv në përdorimin e forcës dhe trajtimin e incidenteve.		trupit në njësi tjera edhe duke u furnizuar përmes procedurave të prokurimit. Gjithashtu Policia e Kosovës do të shqyrtoj bazën ligjore në aspektin e mbrojtjes së të dhënave personale me ç'rast do të jetë në kontakt dhe konsultime të vazhdueshme edhe me Agjencinë për Informim dhe Privatësi.	
6.	IPK u rekomandon përdoruesve dhe mbikëqyrësve të njësive rajonale të trafikut rrugor, që me rastin e përdorimit të kamerave të trupit, apo me rastin e shkarkimit të provave digjitale, të kujdesen që ato klasifikohen për qëllime të ruajtjes dhe administrimit të duhur të tyre.	-1-	Drejtori i Departamentit të Rendit Publik urdhëron Drejtorët Rajonal dhe Shefat e Operativës Rajonale që përmes Komandantëve të Njësive të Trafikut (NJRTRR dhe NJKA) të sigurohen se PSO "Përdorimi dhe administrimi i sistemit të kamerave të trupit" është përcjellë mjaftueshëm tek përdoruesit e kamerave të trupit e gjithashtu edhe procedura e shkarkimit të provave digjitale dhe klasifikimi për qëllim të ruajtjes dhe administrimit është kuptuar mjaftueshëm nga përdoruesit e kamerave. Nëse është e nevojshme të mbahen edhe trajnime të veçanta.	Në vazhdimësi
7.	IPK u rekomandon përdoruesve të kamerave të trupit, që gjithherë kur i përdorin ato për qëllime operative, t'i njoftojnë palët se janë të ekspozuar gjatë monitorimit të ushtruar.	-1-	Drejtori i Departamentit të Rendit Publik dhe Drejtori i Departamentit të Kufirit urdhërojnë njësitë vartëse të tyre të inspektohen zyrtarët në teren si dhe të njoftohen zyrtarët lidhur me çështjet e potencuara në këtë rekomandim.	Në vazhdimësi
8.	Me gjithë ngarkesën në punë, problemet teknike në sistem dhe sfidat në implementimin e projektit, IPK i rekomandon Administratorit të Sistemit të Kamerave, që shtojë përpjekjet për procedimin me kohë të kërkesave që vijnë nga njësitë policore që janë ngarkuar me përdorimin e sistemit të kamerave.	-1-	Drejtori i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse urdhëron Drejtorin e DTIK-ut që përmes njësive përkatëse të procedoj tutje dhe me kohë kërkesat e Divizioneve / Drejtorive dhe Njësive lidhur me instalimin e kamerave të trupit dhe pajisjeve përcjellëse të tyre si dhe përmirësimin e tyre në rast të defekteve, në të gjitha njësitë ku janë të shpërndara të njëjtat.	Instalimi i të gjitha kamerave të trupit dhe pajisjeve përcjellëse të tyre për të gjitha njësitet kërkuese deri në periudhën kohore K1-2025.  Përmirësimi (servisimi) i kamerave të trupit në rast defekti. Në vazhdimësi

Kohëzgjatja mesatare në minuta e incizimeve të regjistruara nga zyrtarët e mostruar brenda orarit tetë orë të punës (15-31 tetor 2024)

